



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

Nr. 1 Prot.

Datë, më 05.04.2023

V E N D I M

Nr. 01 . datë 05.04.2023

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË EKSPERTIT DHE MARRËVESHJEVE TË TRANSFERIMIT TË VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, të V.K.M. nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të nenit 7 të Statutit të shoqërisë, të Marrëveshjeve për Transferim Aktiviteti, si dhe të Raportit të Transferimit të Veprimtarisë Ekonomike datë 02.03.2023, të përgatitur nga Eksperti Auditues Ligjor Z. Sokol Toska, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit të Transferimit të Veprimtarisë Ekonomike datë 02.03.2023, të përgatitur nga Eksperti Auditues Ligjor z. Sokol Toska.
2. Miratimin e Marrëveshjes noteriale të Transferimit të veprimtarisë ekonomike, të lidhur midis Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve Dibër Sh.a. dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizimeve Dibër Sh.a.
3. Miratimin e Marrëveshjes noteriale të Transferimit të veprimtarisë ekonomike, të lidhur midis Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve Dibër Sh.a. dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizimeve Mat Sh.a.
4. Miratimin e Marrëveshjes noteriale të Transferimit të veprimtarisë ekonomike, të lidhur midis Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve Dibër Sh.a. dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizimeve Bulqizë Sh.a.
5. Miratimin e Marrëveshjes noteriale të Transferimit të veprimtarisë ekonomike, të lidhur midis Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve Dibër Sh.a. dhe Bashkisë Klos.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

6. Të autorizojë Administratorin e shoqërisë z. Mario Bakalli të nënshkruajë të gjithë dokumentat si dhe të kompletojë të gjitha procedurat e nevojshme për finalizimin e transferimit të veprimtarive.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

Bashkia Dibër
Rrahim Spahiu

Bashkia Bulqizë
Gëzim Xhafa

Bashkia Mat
Agron Malaj

Bashkia Klos
Ilmi Hoxha

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Klevis Jahaj